


Statistika të Diplomimeve

2022-2023

Tiranë, më 21 Maj 2024: Në vitin shkollor 2022-23, u diplomuan në arsimin zyrtar 83.548 nxënës dhe studentë, 34,1 % në arsimin 9 vjeçar, 32,4 % në arsimin e mesëm dhe 33,5 % në arsimin e lartë.


Fig.1 Përqindja e nxënësve dhe studentëve të diplomuar në arsim sipas niveleve arsimore, 2022-23



Arsimi Parauniversitar (deri i mesëm i lartë)

Në vitin shkollor 2022-23, në arsimin 9-vjeçar u diplomuan 28.488 nxënës, nga të cilët 52,6 % ishin djem dhe 47,4 % vajza.

Fig. 2 Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar sipas gjinisë




Në arsimin e mesëm u diplomuan 27.069 nxënës, 47,2 % djem dhe 52,8 % vajza. Në arsimin profesional u diplomuan 3.212 nxënës, 82,3 % djem dhe 17,7 % vajza. Të diplomuarit e arsimit profesional përbëjnë 11,9 % të të diplomuarve gjithsej në arsimin e mesëm.

Arsimi i Lartë

Në vitin akademik 2022-23, u diplomuan në arsimin e lartë 27.991 studentë. Studentët e diplomuar në programet Bachelor përbëjnë 49,3 % e studentëve të diplomuar gjithsej, ndjekur nga programet Master me 44,6 %. Në të gjithë programet e arsimit të lartë, në këtë vit akademik, u diplomuan 18.241 studente femra, ose 65,2 % e numrit të përgjithshëm të studentëve të diplomuar në arsimin e lartë.


Fig. 3 Të diplomuar në arsimin e lartë sipas programeve të studimit dhe gjinisë, 2022-23



Fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentë në të gjitha programet është “Biznes, administrim dhe ligj” prej 25,4 % ose një e katërta e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve, si për femrat dhe për meshkujt. Fusha e dytë më e preferuar nga meshkujt është “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 22,5 % të të diplomuarve meshkuj. Ndërsa, nga femrat gjithsej të diplomuara, fusha e dytë më e preferuar është “Shëndet dhe mirëqenie” me 22,9 % të të diplomuarve.

Analizuar për secilën fushë veças, fushat në të cilat janë diplomuar më shumë femrat krahasimisht me meshkujt janë “Arsim” (82,6 %), ndjekur nga “Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë” (80,5 %) dhe “Shkenca sociale, gazetari dhe informacion” (79,7 %). Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë meshkujt krahasimisht me femrat janë “Shërbime” (68,8 %), “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” (62,5 %), dhe “Teknologji e informacionit dhe komunikimit” (58,5 %).

Fig. 4 Të diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit dhe gjinisë, 2022-23



Aneks

Tab.1 Nxënës të diplomuar në arsimin parauniversitar (deri i mesëm i lartë)

ISCED-2011	Niveli arsimor	2020-21			2021-22			2022-23		
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
1+2	Në arsimin 9 vjeçar	15.172	17.007	32.179	14.346	15.565	29.911	13.512	14.976	28.488
3	Në arsimin e mesëm	16.420	14.716	31.136	15.080	14.423	29.503	14.295	12.774	27.069
	<i>Gjimnaz dhe Social-Kulturor</i>	15.680	11.625	27.305	14.386	11.441	25.827	13.726	10.131	23.857
	<i>Profesional</i>	740	3.091	3.831	694	2.982	3.676	569	2.643	3.212

Tab. 2 Studentë të diplomuar në arsimin universitar

ISCED-2011	Niveli arsimor	2020-21			2021-22			2022-23		
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
5	Programe 2 vjeçare	597	725	1.322	816	846	1.662	743	841	1.584
6	Bachelor	11.660	5.990	17.650	10.455	5.562	16.017	8.731	5.077	13.808
7	Master	9.074	4.251	13.325	9.046	3.916	12.962	8.708	3.775	12.483
8	Doktoraturë	261	132	393	172	97	269	59	57	116
	Gjithsej	21.592	11.098	32.690	20.489	10.421	30.910	18.241	9.750	27.991

Tab. 3 Studentë të diplomuar në arsimin universitar sipas fushave të studimit

Niveli arsimor	2020-21			2021-22			2022-23		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Shkenca arsimit	2.686	578	3.264	2.580	630	3.210	2.047	430	2.477
Arte dhe shkenca humane	2.522	635	3.157	2.183	541	2.724	1.602	441	2.043
Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	2.388	631	3.019	2.344	629	2.973	2.075	528	2.603
Biznes, administrim dhe ligj	6.525	3.291	9.816	5.639	2.779	8.418	4.734	2.367	7.101
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	738	231	969	791	243	1.034	658	159	817
Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	703	1.127	1.830	785	1.093	1.878	822	1.160	1.982
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	1.160	2.102	3.262	1.305	2.216	3.521	1.315	2.192	3.507
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	543	676	1.219	536	553	1.089	442	474	916
Shëndet dhe mirëqenie	3.948	1.155	5.103	3.927	1.002	4.929	4.169	1.167	5.336
Shërbime	379	672	1.051	399	735	1.134	377	832	1.209
Gjithsej	21.592	11.098	32.690	20.489	10.421	30.910	18.241	9.750	27.991

Metodologjia

Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit:

Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe/kopshte

Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë – Gjimnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes, jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë, cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime:

Arsimi zyrtar është përcaktuar si arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe private, të njohura (liçensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna ose me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevoja të veçanta dhe disa pjesë të arsimit për të rritur, shpesh të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin, atë social–kulturor dhe arsimin profesional, cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë.

Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të hartuara me qëllim përfitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave specifike për një profesion të veçantë ose klasë të profesioneve.

I diplomuar në një program arsimor është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.

Të dhënat mbi statistikat e diplomimeve janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf, Politika e revizionimit statistikor.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat e statistikave të arsimit sigurohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me periodicitet vjetor.